



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
PROKURORIA E PËRGJITHSHME

**SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE
DHE PËR PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL
NË KATEGORINË EKZEKUTIVE (Specialist)**

Njoftim për vënd pune të lirë në administratë në pozicionin “specialist finance”, në Sektorin e Financës dhe Buxhetit, në Drejtorinë e Ekonomike dhe Financës në Prokurorinë e Përgjithshme.

Në mbështetje të Ligjit nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar, Kreut IV, “Pranimi në shërbimin civil”, neni 23, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.243, datë 18.03.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e proves dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, Prokuroria e Përgjithshme, shpall konkurrimin për nëpunës civil të kategorisë ekzekutive III-b, pika 2, klasa B, për vëndin e punës në pozicionin “**specialist – finance**”. Proçedura e rekrutimit, përzgjedhjes dhe periudha e provës do të realizohet:

Pozicionet më sipër, u ofrohen fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele!

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori;
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”;

Vetëm në rast se nga ky pozicion, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicion vakant, ai është i vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimi në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Data e dorëzimit të dokumentave: 10.10.2023

****Afati i aplikimit dhe dorëzimit të dokumentacionit është i njëjtë për të dyja procedurat.***

A) Konkurrimi për vëndin e punës në pozicionin “specialist-finance”, në Sektorin e Buxhet Financës në Prokurorinë e Përgjithshme Tiranë, do të bazohet në:

1. Ligjin nr.97/2016, “Per organizimin e funksionimin e Prokurorisë së Përgjithshme;
2. Ligji nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,
3. Ligji nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar,
4. Ligjin nr.10296, date 08.07.2010 “Per menaxhimin financiar dhe kontrollin”

5. Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar,
6. Ligjin nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar,
7. Ligjin nr.7961 datë.12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

B) Konkurrimi do të zhvillohet në dy faza:

I. Faza e parë:

- Verifikimi paraprak i kandidatëve për plotësimin e kërkesave të përgjithshme dhe atyre të veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurim
- Sektori i Burimeve Njerëzore në bazë të dokumentacionit të paraqitur, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga data e mbylljes së pranimi të tyre, do të bëjë verifikimin paraprak të kandidatëve, që përmbushin kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurim
- Kandidatët që plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta të pozicionit të punës, renditen në një listë sipas rendit alfabetik e cila administrohet në S.B.Nj dhe do të shpallet në faqen zyrtare të internetit PP dhe në hyrjen kryesore të Prokurorisë së Përgjithshme.
- Kandidatët, që nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara në shpalljen për konkurim, renditen në një listë të veçantë në të cilën regjistrohen edhe arsyet e mosplotësimit të këtyre kërkesave. Kjo listë nuk publikohet dhe administrohet në S.B.Nj e cila njofton në mënyrë individuale kandidatët që nuk janë kualifikuar.
- Çdo kandidat ka të drejtë të paraqesë ankesë pranë S.B.Nj, brenda 5 (pesë) ditëve kalanderike nga data e shpalljes së listës. Ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalanderike nga data e depozitimit të ankesës

II. Faza e dytë përbëhet nga vlerësimi i kandidatëve që përfshin:

- Vlerësimin e jetëshkrimit të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, si dhe vlerësimet e arritjeve vjetore
- Vlerësimi me shkrim.
- Intervista e strukturuar me gojë.

C) Pranimi do të bëhet për 1 (një) vend pune në pozicionin “specialist- finance”.

Ç) Për pranimin në shërbimin civil, kandidati duhet të plotësojë *kërkesat e përgjithshme* sipas nenit 21, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si më poshtë:

- Të jetë shtetas shqiptar.
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur.
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.

- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas këtij ligji.

D) Kërkesat e veçanta që janë prioritet në përzgjedhjen e kandidatëve:

- Të ketë përfunduar arsimin e lartë dhe të jetë diplomuar me diplomë të nivelit Master Shkencor për **finance-kontabel**.
- Të ketë përvojë pune, jo më pak se **10 vjet**, prioritet përbën që përvoja punës të ketë lidhje me detyrat kryesore që do të kryeje në këtë pozicion pune.
- Të ketë njohuri dhe përdorim të programe Alpha Web Buxhetor.
- Zotërimi i një gjuhe të huaj të BE-së është prioritet.
- Prioritet është përvoja e punës në sistemin buxhetor.
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup.

DH) Pozicionin “specialist – finance” ka këto detyra dhe përgjegjësi kryesore, por jo vetëm:

- * Specialisti i Sektorit të Finances dhe Kontabilitetit varet nga Drejtori i Drejtorisë Ekonomike dhe Finances dhe raporton e informon në mënyrë të rregullt në lidhje me çdo problem që lind gjatë zbatimit të veprimeve ekonomike, financiare në përputhje me ligjin e Kontabilitetit dhe aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi ;
- * Harton, dhe zbaton procedurat për planifikimin e nevojave për fonde buxhetore (shpenzimet operative) afatmesme të Aparatit të Prokurorisë së Përgjithshme duke ju referuar udhëzimeve dhe taveaneve të dërguara nga Ministria e Financave si dhe i paraqet për diskutim të përgjegjësi i Sektorit duke bashkëpunuar paraprakisht me specialistët e tjerë të sektorit;
- * Ndjek realizimin e investimeve për Aparatin e Prokurorisë, propozon rialokimin e fondeve të lira sipas kërkesave dhe mundësive që ka institucioni dhe i paraqet për diskutim të përgjegjësi i Sektorit.
- * Harton Pasqyrat Financiare të Aparatit të Prokurorisë së Përgjithshme dhe i paraqet ato për diskutim të përgjegjësi i Sektorit dhe miratim të Drejtori i Drejtorisë Ekonomike dhe Finances brenda datës 10 Shkurt të çdo viti
- * Ndjek vazhdimisht mënyrën e krijimit dhe administrimit të të ardhurave dytësore që krijohen nga aktivitete të ndryshme në Aparatin e Prokurorisë dhe i raporton se bashku me evidencat e tjera të Përgjegjësi i Sektorit.
- * Ndjek të gjitha pagesat për mallrat dhe shërbimet që realizon institucioni, përgatit Urdher shpenzimet e depoziton në Degën e Thesarit të gjitha kontratat që ka institucioni për mallra dhe shërbime, kontrollon rregullsinë e dokumentacionit shoqerues duke bashkëpunuar paraprakisht me specialistët e tjerë të sektorit dhe i paraqet për miratim të Drejtori i Drejtorisë Ekonomike dhe Finances.
- * Evidenton kontabilitetin e veprimeve të bankës dhe të arkës dhe i regjistron ato në programin ALPHA, duke bërë rakordimet perkatëse të të dhënave të llogarive me situacionin mujor dhe vjetor të shpenzimeve të miratuara nga Dega Rajonale e Thesarit;

- * Pergatit cdo 4/ mujor regjistrin e realizimit te prokurimeve publike per Aparatin e Prokurorise;
- * Kryen dhe detyra te tjera me urdher te vecante sipas nevojave te lindura gjate ushtrimit të funksionit ne Prokurori.

G) Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

Të gjithë kandidatët si më sipër duhet të dorëzojnë dokumentacionin si më poshtë:

- a.- Jetëshkrimin;
 - b.- Fotokopje të diplomës;
 - c.- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë përvojën në punë);
 - ç.- Çdo dokumentacion që vërteton eksperiencën të tjera punësimi brenda ose jashtë vendit, të lëshuar nga punëdhënësi;
 - d.- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.
- Kandidatët nga jashtë shërbimit civil, përveç sa më sipër duhet të dorëzojnë dokumentacionin si vijon:
- a.- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
 - b.- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
 - c.- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;

Mënyra e dorëzimit me postë ose e drejtpërdrejtë në protokollin e institucionit me adresë: Prokuroria e Përgjithshme/Spektori i Burimeve Njerëzore (konkurrimi për vendin e punës në pozicionin “specialist – finance”) me adresë: Rruga “Qemal Stafa, nr.1, Tiranë.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:

- Vlerësimi i jetëshkrimit të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, si dhe vlerësimet e arritjeve vjetore;
- Vlerësimi me shkrim;
- Intervista e strukturuar me gojë.
- Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100, të cilat ndahen përkatësisht:
- Për vlerësimin e jetëshkrimit (cv) të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, si dhe vlerësimet e arritjeve vjetore, **15 pikë**;
- Për vlerësimin me shkrim, **60 pikë**.
- Për intervistën e strukturuar me gojë, **25 pikë**;

i) Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët do të bëhet nëpërmjet adresave të email-, me mesazhe në numrin e celularit të kandidatit, në faqen e internetit të Prokurorisë së Përgjithshme.

Për me shume informacion për Prokurorinë e Përgjithshme dhe veprimtarinë e saj mund te vizitoni edhe faqen tonë në internet: www.pp.gov.al;

PROKURORIA E PËRGJITHSHME

18.09.2023